VENDIM
Nr.26, datë 18.6.2010

PËR MIRATIMIN E TARIFAVE TË UJIT PËR KONSUM PUBLIK
PËR UJËSJELLËS KANALIZIME SHA RROGOZHINË

Në mbështetje të nenit 14 dhe 21 të ligjit nr.8102, datë 28.3.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", të ndryshuar, si dhe metodikës "Mbi vendosjen e tarifave të ujit për konsum publik" në zbatim të këtij ligji, Komisioni Kombëtar Rregullator i ERRU-së,

VENDOSI:

1. Të miratojë tarifat e ujit për konsum publik për Ujësjellës Kanalizime sh.a. Rrogozhinë, si më poshtë:

	Për ujin e pijshëm	Për ujërat e ndotura
Konsumatorë familjarë:	45 lekë/m^3	8 lekë/m^3
Institucione buxhetore:	80 lekë/m^3	10 lekë/m^3
Ente private:	90 lekë/m^3	10 lekë/m^3

2. Pagesa rregullatore do të jetë 0.8% e të ardhurave vjetore të llogaritura.

3. Ky vendim hyn në fuqi më 1.7.2010 dhe është i vlefshëm deri në miratimin e tarifave të reja.

KRYETARI
Avni Dervishi